



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

NJOFTIM

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, DPD fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë pranë kësaj Drejtorie për të përfituar STATUSIN E EKSPORTUESIT TE MIRATUAR. Ky autorizim u mundëson kompanive vërtetimin e origjinës preferenciale të mallrave në eksport drejt vendeve të Bashkimit Evropian, Vendeve Anëtare CEFTA 2006 dhe Republikës së Turqisë, nëpërmjet deklaratës faturë, pa patur nevojë për EUR 1.

Kompania duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë DPD-së/Departamentit Teknik për marjen e Statusit, të plotësojë formularin tip të aplikimit dhe të paraqesë të gjithë dokumentacionin shtesë, në mbështetje të kërkesës.

Për të përfituar Statusin e Eksportuesit të Miratuar, kompania duhet:

- Të prodhojë mallra me origjinë Preferenciale Shqiptare
- Të ketë eksportuar këto lloj mallrash me Certifikatë Lëvizjeje EUR 1, për një periudhë prej jomë pak se 2 vjet nga data e kërkesës
- Të mos ketë patur asnjë kontestim nga Doganat Homologe për Certifikatën EUR1.
- Të ketë një frekuencë prej jo më pak se një ngarkesë në muaj (12 eksporte/vit) gjatë vitit aktual të aktivitetit.

I gjithë dokumentacioni i nevojshëm, përfshi edhe formularin tip mund ta gjeni në adresën e internetit www.dogana.gov.al/origjina

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave